



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al

e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

V E N D I M

Nr. 20, datë 30.03.2017

Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit anëtarit të këshillit bashkiak

Në mbështetje të nenit 49 pika 1, nenit 54 shkronja "j", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 164 pika 2 e Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, vendimit nr. 962, date 28.07.2015 të KQZ-së "Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015", vendimit nr. 33, datë 7.2.2017 të KQZ-së, shkresës nr 1533 prot, datë 16.3.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "për vazhdimin e procedurave për plotësimin e vakancës me kandidatin znj. Mimoza Shefik Shkjau", listës shumëmemërore "për kandidatët për këshillin bashkiak Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015" të subjektit Partia Balli Kombëtar Demokrat, Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 30.03.2017, me propozim të komisionit të mandateve,

V E N D O S I

1. Plotësimin e vakancës dhe miratimin e dhënies së mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Shkodër znj. **Mimoza Shefik Shkjau**, si kandidate e radhës me numer rendor 6, në listën shumëmemërore të Partisë Balli Kombëtar Demokrat, "Për anëtarë të këshillit bashkiak Shkodër, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI